Neni 1

Neni 7

Neni 27

Neni 69

Ne sipas ligjit per prokurimin publik, kemi kerkuar kerkese per rishqyrtim per kete aktivitet per zgjidhje preeliminare te mosmarrevshjes ashtu sic parahishet ne LPP, dhe kemi pranuar REFUZIM nga AK-SHSKUK duke mos trajtuar anje nga pikat tona te meposhtme:

Ne tenderin e shpallur nga SHSKUK, Furnizim me material me nr prokurimit: 00220-25-987-1-1-1 me date 19.02.2025, ne si kompani e interesuar per pjesmarrje kerkojme nga ju si Autoritet te respektoni nenin 1,7, 27 dhe 69.

Gjate analizimit te dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate eshte kerkuar dhe kerkojme nga autoriteti kontraktues-shskuk te beje ndryshimet e duhura:

Pika 1.

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit 2022,2023,2024 është jo më pak se Lot 1 – 6,000,000.00 Euro (Katër milion e pesëqind mijë Euro) Lot 2 - 600,000.00 Euro (Gjashtë qind mijë Euro) Lot 3 – 6,500,000.00 Euro (Tre milion Euro) dhe Lot 4 – 3,500.000.00 Euro (Katër milion e tetëqind mijë Euro). Lideri i Grupit të Operatorëve ekonomik duhet të ketë 51% e qarkullimit financiar sipas UDHËZUESIT Nr.001 2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Evidenca 1. Të dëshmohet me deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.

- **Pra kerkesa e kompanise sone eshte qe ky kriter diskriminues te largohet apo te zvogelohet ne mase te madhe, per arsye se kufizohet konkurrenca dhe keto kerkesa jane jo ne harmoni me proceduren tenderuese.**

Pika 2.

Nr.001 2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Evidenca 1. Të dëshmohet me deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur. Kërkesa 2. Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin në fjalë ose qasje në kredi të pa kushtëzuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia. LOT 1 1,000,000.00 euro LOT 2 200,000.00 euro LOT 3 1,000,0000.00 euro LOT 4 800,000.00.

Evidenca 2.Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi të pakushtëzuar. Dokumenti duhet të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar

me titull të projektit. Ne raste të konzorciumit lideri i konzorciumit të këtë minimum 51% të vlerës së kerkuar te mjeteve.

- **Pra kerkesa e kompanise sone eshte qe ky kriter diskriminues te largohet apo te zvogelohet ne mase te madhe, pasi qe ligji I prokurimit publik parasheh qarte se operatoret ekonomik nuk mund te diskriminohen ne asnje menyre dhe ne asnje variant.**

Pika 3.

Kërkesa 5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë te kontratave te natyrës se ngjashme te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit 1.3 here ne vlerë te lotit (vlerës së parashikuar), ose loteve qe oferton. Në rast të grupit te Operatorëve Ekonomik (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar

Evidenca 5. Të dëshmohet me listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të B05 Njoftim per Kontrat 6 / 8 bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë (trasaksioni bankar).

- **Pra kerkesa e kompanise sone eshte qe ky kriter diskriminues te largohet apo te zvogelohet ne mase te madhe!**

Me keto kerkesa kerkojme nga Autoriteti juaj te na aprovoni dhe te veproni konform LPP,

VENDIM

- **APROVOHET,** Ankesa e Kompanise sone si e BAZUAR,
- **NDRYSHOHEN,** kerkesat qe u ceken me larte dhe behet ndryshimi I dosjes se tenderit dhe njoftomit per kontrate